



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0216

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “N.N.SH. "Vizion Project” kundër Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të KOMUNA LIPIJAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan.” me nr. të prokurimit: "613-23-536-2-2-3", me 23.05.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “N.N.SH. "Vizion Project ”me nr. 2024/0216, e datës 15.03.2024, kurse vendimi i AK Komuna Lipijan lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan.” me nr. të prokurimit: "613-23-536-2-2-3", mbetet në fuqi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “N.N.SH. Vizion Project”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.02.2023, KOMUNA LIPIJAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Konkursin e Projektimit B06 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan.” me nr. të prokurimit: "613-23-536-2-2-3"Ndërsa me datën 28.02.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 45,000.00euro.

Me 04.03.2024, OE "N.N.SH. "Vizion Project" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 05.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "N.N.SH. " Vizion Project "me nr. 216/24 për lidhur me aktivitetin "Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektivin e Qendrës Kulturore ne Lipjan." me nr. të prokurimit: "613-23-536-2-2-3".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mos marrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "N.N.SH. " Vizion Project "janë parashtruar si në vijim:

Sqarim hyrës : "Në vlerësimin e projekteve ideore të paraqitura për Konkursin e projektimit për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan, AK ka zbuluar disa probleme thelbësore që kanë ndikuar në vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Këto probleme përfshijnë vlerësime subjektive dhe joreale nga ana e Komisionit të Vlerësimit të AK-së, që kanë çuar në rezultate jo të drejta dhe të pashpjegueshme për aplikuesit. Në veçanti, vendimet e OSHP-së janë shkelur nga Komisioni i Vlerësimit të AK-së, e cila nuk ka respektuar rekomandimet e OSHP-së dhe ka vazhduar të bëjë vlerësime subjektive. Ekspertizat e OSHP-së kanë konfirmuar shkeljet ligjore të Autoritetit të Kontraktimit, duke theksuar nevojën për rivlerësim të lëndës. Megjithatë, edhe pas këtyre konfirmimeve, vlerësimi i subjektivitetit ka vazhduar në fazën e rivlerësimit të tretë. Në kërkesën për qasje në dokumente publike, është vërejtur mungesa e informacionit të plotë dhe të qartë nga ana e Autoritetit të Kontraktues, duke përjashtuar komentet e anëtarëve të komisionit vlerësues që do të mund të ndihmonin në kuptimin e pikëve të dhëna për secilin kriter. Kjo sugjeron mungesë profesionalizmit dhe kompetencash në përgatitjen dhe vlerësimin e tenderëve të këtillë.

Vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është marrë në përputhje me këto konstatime, dhe tregon përgjegjësinë e AK-së për zbatimin e procedurave të drejta dhe transparente në prokurimet publike. AK KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN anulon aktivitetin e prokurimit për arsyeje se asnjë OE ofertues nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes. Për vlerësimin subjektiv dhe jo të drejtë të AK-së në aktivitetin e prokurimit. Tabela e bashkëngjitura në raportin e ekspertit tregon qartë ndryshimet në vlerësim mes ofertave, duke dëshmuar një trajtim jo të barabartë të aplikuesve. Kjo tregon se AK-ja ka vepruar jashtë ligjit duke anashkaluar rekomandimet dhe vendimet e OSHP-së. "

Pretendimi i parë (I): “Siç vërehet qartë, projektet ideore me shifrat 7373 dhe 1119 nuk kanë respektuar fillimisht obligimet ligjore që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor, për arsye se : Projektuesi me shifrën 7373 në projektin e tij nga ana perëndimore e parcelës, që kufizohet me objektet e banimit distanca nga vija kufitare ka paraparë një distancë prej rreth 2.6m, ndërsa siç shihet më lartë, në Detyrën e dhënë Projektuese kërkohet që “distanca nga vija kufitare duhet të jetë së paku 7 m”. Po ashtu, shihet qartë se ndërtesa e projektuar nga shifra 7373 në pjesën veriore ka prekur kufirin e parcelës, që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor. Me këto veprime, projektet me shifrat 7373 dhe 1119 kanë shkelur kërkesat obligative ligjore të Detyrës Projektuese të këtij konkursi të projektimit, si dhe rrjedhimisht janë shkelur edhe dispozitat ligjore të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe akteve nënligjore në fuqi të planifikimit hapësinor. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së, ku në super ekspertizën e dt.19.06.2023 me NR. 263/23, konstaton, citojmë: “Eksperti shqyrtues ka analizuar skicat e ofruara të projektit – situacionin e ngushtë ku janë të paraqitura dimensionet e pozicionimit të objektit në kuadër të parcelës. Sipas detyrësprojektuese AK i ka dhënë kufizimet në kuadër të shtrirjes së objektit duke i deklaruar distancat kufizuese sipas përkrahimit : “Duke pasur parasysh situatën e parcelës ku planifikohet ndërtimi i qendrës kulturore në Lipjan distancat nga rrugët duhet planifikuar si në vijim nga rruga “Komandant Kumanova” së paku 15m; Nga rruga “Haxhi Kleçka” së paku 10m: Nga ana perëndimore që kufizohet me objektet e banimit distanca nga vija kufitare duhet të jetë së paku 7m. Projektuesi me kodin 7373 nga ana perëndimore e parcelës e ka pozicionuar objektin në distancën kufizuese nga parcela në vetëm 2.62m, duke mos respektuar kufizimin e detyrës projektuese që është kërkuar se paku 7m këtu gjatë vlerësimit është dashtë të merret parasysh kriteri 4. Kriteri i lëvizshmërisë – nën kriteri lëvizja pa pengesa e këmbësoreve dhe automjeteve (ku projekti në fjalë është poentuar për këtë kriter me pikë maksimale); në këtë rast pengohet – pamundësohet lëvizja e makinave të zjarrfikësve dhe furnizimeve pasi që në këtë pjesë është vendosur hyrja ekonomike dhe gjerësia nga kufiri i parcelës e deri te objekti është 2.62m””. – mbarim citati Komisioni Vlerësues i emëruar nga AK për Rivlerësimin e projekteve, sërish ka bërë po të njëjtat shkelje ligjore si komisioni paraprak duke poentuar me pikë maksimale projektin me kodin 7373 ani pse Eksperti Teknik e ka bërë të qartë se ky projekt nuk plotëson këtë kriter. Projekti me kodin 7373 duke mos respektuar këto distanca të dhëna nga AK ka shkelur dhe Kriterin 1 – Kriteri Hapësinor me saktë këto nën kritere : Konceptin hapësinor të zgjidhjes urbane : Cilësia e organizimit të hapësirës :Paraqitja grafike dhe teknike e projektit Projekti me kodin 7373 ka shkelur dhe Kriterin 2 – Kriteri programor me saktë këto nën kritere : Shfrytëzimi racional i hapësirës : Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor duke mos respektuar kriteret e cekura më lartë. Komisioni për vlerësimin e ofertave i AK-së ka shkelur Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurim Publik, përkatësisht nenin 19.11. Specifikimet teknike, ku saktësisht sqarohet se “Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t’i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm”. - Projektuesi me shifrën 1119 në projektin e tij, situacioni nuk është i prezantuar si duhet pasi që në këtë projekt nuk është prezentuar fare përpjesa e vizatimit, si dhe nuk janë dhënë as dimensionet se sa është e larguar ndërtesa nga kufiri i parcelës. Kjo e bën të pamundur të dihet dhe të kuptohet se projekti me shifrën 1119 a e ka vendosur ndërtesën në raport të duhur me parcelën, sipas kërkesave të Detyrës projektuese dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit dhe akteve tjera nënligjore të këtij legjislacioni në fuqi. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së në super ekspertizën e dt.19.06.2023 me NR. 263/23 ku konstaton, citojmë:

“Pas shqyrtimit të projektit me kodin 1119 eksperti shqyrtues konstaton qe projektuesi ne situacionin e ngushtë nuk i ka paraqitur të dhënat e kompletuara dhe është i mangët, sipas ligjit të ndërtimit dhe rregullave të projektimit, në rast se mungon vija e ndërtimit – dimensionet e pozicionimit të objektit në kuadër të parcelës ose koordinatat gjeodezike përmes të cilave do të pozicionohej objekti. Rregullorja nr.001-2022, Neni 55.1 Konkursi për projektim është një procedurë në bazë të së cilës ftohen Operatorët Ekonomik që ta dorëzojë projektimin ideor të tyre të një projekti fizik. Projektimi ideor që formon komponentin kryesor të Konkursit për Projektim pritet t’i nxjerr në pah aspektet estetike të projektit përveç karakteristikave teknike. Projektimi ideor është një projektim preliminar që do të pasohet me një projektim të detajuar. Do të thotë që mangësitë e cekura në projektin ideor i pamundësojnë komisionit një vlerësim real mbi kriteret e kërkuara për vlerësimin në dosje të tenderit (kriteri hapësinor, kriteri programor, kriteri i lëvizshmërisë) dhe këto mangësi duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të projekteve në poentimin e tyre. Marrë parasysh këto fakte konsideroj qe sa i përket pikës 1.a) pretendimi 1 – për kodin 7373 dhe kodin 1119 pretendimi është i gabuar. – mbarim citati. Komisioni Vlerësues i emëruar nga AK për Rivlerësimin e projekteve serish ka vepruar kundërligjshëm pasi qe nuk ka marrë parasysh fare Vendimin e OSHP-së si dhe nuk ka respektuar kriteret bazë të përcaktuara në FDT dhe nuk ka respektuar Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Komisioni sërish e ka poentuar me pikë projektin me kodin 1119 ani pse ky projekt nuk plotëson asnjë nga kriteret e dhëna në FDT. Duke mos respektuar kriteret e cekura me lartë. Komisioni për vlerësimin e ofertave të AK-së ka shkelur Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurim Publik, përkatësisht nenin 19.11 Specifikimet teknike, ku saktësisht sqarohet se “Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t’i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm”.1.b)Po ashtu, vërehet qartë që projekti ideor me shifrën 7373 nuk ka respektuar as obligimet ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga zjarri për arsye se : - Në projektin e tij nuk janë prezentuar dhe planifikuar fare DALJET EMERGJENTE, që është obligim ligjor në Kosovë. Më këto veprime, projekti me shifrën 7373 ka shkelur RREGULLOREN Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA, përkatësisht Nenin 30 të kësaj rregulloreve, ku përcaktohet qartë nevoja dhe mënyra e planifikimit të Korridorit dhe rrugës së evakuimit emergjent. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së në super ekspertizën e dt.19.06.2023 me NR. 263/23 ku konstaton, citojmë : “Eksperti shqyrtues konsideron që duke pasur parasysh rëndësinë e projektit – Kategoria II e objekteve, duhet trajtuar aspektin e sigurisë dhe lëvizshmërisë së personave dhe makinerisë në raste emergjente, pasi që ka qenë edhe kriteri 4 i vlerësimit – Kriteri i lëvizshmërisë. Projektuesi në projektin ideor i cili është bazë për hartimin e projektit.”

Pretendimi i dytë (II): “Në Detyrën Projektuese tek kapitulli Hapësira e përgjithshme e objektit, AK ka kërkuar që Sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore të jetë minimum 8900 dhe max 9200 m². Projektet me shifrat 7373 dhe 1001 nuk kanë dhënë fare në sipërfaqe totale të ndërtesës së Qendrës Kulturore dhe në këtë mënyrë e kanë bërë të pamundur vlerësimin se a është respektuar nga ata ky kriter. Projektet me shifrat 7373, 1001 dhe 1119 nuk kanë respektuar as kërkesat e Detyrës Projektuese dhe normat teknike të projektimit të Sallës së madhe dhe sallës koncertale me hapësirat tjera mbështetëse. Argumentet tona të qëndrueshme që e dëshmojnë këtë mosrespektim sa i përket 2 Sallave dhe hapësirave tjera mbështetëse janë me sa vijon.

Mosrespektimi nga ana e projektit me shifër 7373 : - Në këtë projekt shihet qartë se nuk është planifikuar erë mbrojtësi i Sallës së madhe : - Projekti 7373 nuk ka planifikuar erë mbrojtës as për sallën koncertale : Duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e Sallës së madhe dhe të Sallës

koncertale, mungesa e erë mbrojtësit pamundëson funksionimin adekuat të këtyre dy hapësirave për arsye se mundësohet që zhurma nga hollitë të depërtojë në brendësi të këtyre dy hapësirave;- Salla koncertale nuk është projektuar sipas standardeve të projektimit të sallave koncertale, për arsye se e gjitha është projektuar në të njëjtin nivel të lartësisë (si skena, ashtu edhe pjesa e auditoriumit) - Salla e madhe hyrjen për furnizim të skenës dhe të hapësirave tjera teknike e ka të ngushtë (dera është 1,00 m korridorin 1,20 m, duke pamundësuar kështu funksionimin e duhur të sallës së madhe me kapacitet 450 deri 500 persona) - Projekti me kodin 7373 hapësirën e kaldatores e ka përfshirë në korridorin hyrës të sallës së madhe, ku janë hapësirat përcjellëse të sallës. Në këtë mënyrë projektuesi me kodin 7373 në këtë pjesë ku është qasja e artistëve ka planifikuar furnizimin me lëndë djegëse për ngrohje, duke penguar dhe rrezikuar komunikimin dhe funksionimin e sallës së madhe : - Projekti me kodin 7373 nuk ka planifikuar dalje emërgjente për asnjërën sallë. Me këtë veprim janë shkelur dispozitat ligjore të RREGULLORES Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA: - Pjesa e regjisë dhe e projektorit të Sallës së madhe nga projektuesi 7373 është vendosur gabimisht dhe në mënyrë jofunksionale në pjesën prapa skenës së sallës së madhe, në vend se të planifikohen në pjesën pas ulëseve të auditoriumit (në pjesën përballë skenës, ku duhet të shihet nga regjia skena dhe të projektohen pamje nga projektori) : - Lartësia e Sallës së madhe nga projektuesi 7373 është planifikuar të jetë përafërsisht 5 metra, që është lartësi e papranueshme duke pasur parasysh kapacitetin e sallës së madhe prej 450-500 personave. Me këtë lartësi është e pamundur të funksionojë si duhet skena e sallës së madhe : - Në prerjen e Sallës së madhe nuk është prezentuar as “Lakorja e Gylenikut” në bazë të së cilës sipas standardeve të projektimit të sallave koncertale bëhet projektimi i këtyre sallave. Duke mos e prezentuar këtë analizë të domosdoshme të projektimit të sallës së madhe, është e pamundur të vlerësohet se a është siguruar shikimi i papenguar i secilit shikues në auditoriumin e sallës së madhe : - Pjesa e prapaskenës së Sallës së madhe nuk është projektuar sipas standardeve të projektimit të sallave koncertale. Projektuesi 7373 këtë hapësirë të prapaskenës e ka bërë shumë të vogël në raport me kapacitetin e sallës së madhe. Kjo hapësirë përveç që është e vogël si sipërfaqe funksionale, po ashtu i mungojnë edhe hapësirat tjera përcjellëse të skenës, siç janë dhoma e provave, akordimi i instrumenteve, ndërsa hapësirën e gardërobave projektuesi 7373 e ka projektuar me sipërfaqe të pamjaftueshme. Është e rëndësishme të potencohet se projektuesi 7373 në këtë hapësirë funksionale të sallës dhe të artistëve nuk ka arritur të bëjë lidhshmërinë e duhur funksionale të hapësirave mes tyre. Mosrespektimi nga ana e projektit me shifër 1001 : - Ky projekt nuk ka planifikuar hyrje ekonomike për Sallën e madhe : - Nuk ka planifikuar erë mbrojtës për Sallën e madhe dhe po ashtu erë mbrojtës nuk ka planifikuar as për Sallën koncertale:

Projektuesi 1001 tek Skena e teatrit dhe kinemasë nuk ka planifikuar pajisjen me sistem fleksibil – platformë lëvizëse e cila mundëson formimin e hapësirës për orkestrën në pjesën e skenës, ashtu siç është kërkuar në Detyrën Projektuese : Mosrespektimi nga ana e projektit me shifër 1119:- Projekti 1119 nuk e ka projektuar si duhet skenën për Sallën e madhe, kjo pasi që lartësia e saj dhe mënyra se si është paraparë të funksionojë skena në projektin në fjalë është e gabueshme në raport me standardet për projektimin e skenave dhe në raport me numrin e kapacitetit të auditoriumit.- Projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk ka paraparë erë mbrojtës në hyrje të sallave, element ky i cili kërkohet në projektimin e auditoriumeve : erë mbrojtësi apo korridorin e dy dyer në hyrje të shikuesve kërkohet në mënyrë që zhurma nga hollitë të mos depërtojë në sallë. - Si pjesë përcjellëse e sallës së madhe dhe sallës koncertale duhet të jenë edhe gardërobat për pjesën e shikuesve. Këtë hapësirë të domosdoshme përcjellëse për këto salla, projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk e ka vendosur fare. Projektet me shifrat 7373, 1001 dhe 1119 nuk kanë respektuar as kërkesat e Detyrës Projektuese dhe normat teknike të projektimit të

Hapësirave skenike dhe auditoriumit, të Hollit hyrës dhe foajeut, të Hapësirave administrative dhe të Hapësirave të jashtme. Argumentet tona të qëndrueshme që e dëshmojnë këtë mosrespektim janë me sa vijon.- Projekti me shifrën 1001 në projektin e tij, në pjesën e prerjeve, nuk e ka paraqitur si duhet skenën fleksibile të sallës së madhe, duke mos ju përmbajtur detyrës projektuese. Në detyrën projektuese tek hapësirat skenike dhe auditoriumi kërkohet saktësisht që: “Skena e teatrit dhe kinemasë të jetë e pajisur me sistem fleksibil – platformë lëvizëse e cila mundëson formimin e hapësirës për orkestrën në pjesën e skenës”. Ndërsa, projekti me shifrën 1001 ka paraqitur vetëm skenën statike. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së, në super ekspertizën e dt.19.06.2023 me NR. 263/23, ku konstaton, citojmë : Pretendimi për projektin 1001 për skenën fleksibile të sallës së madhe – platformë lëvizëse është trajtuar më sipër dhe ky pretendim është i bazuar. Duhet të merret parasysh tek kriteret e poentimit gjatë vlerësimit të projekteve”, mbarim citati. Komisioni i Vlerësimit të Projekteve nuk e ka marrë për bazë fare këtë kriter dhe po ashtu nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së. - Projekti me shifrën 1001 në projektin e tij nuk e ka vendosur të gjitha kthinat dhe përmbajtjet në pjesën e teknikës dhe regjisë, duke mos ju përmbajtur detyrës projektuese dhe normave teknike për funksionimin e sallës. - Projekti me shifrën 7373 në projektin e tij nuk ka parapare gardëroba për pjesën e Sallës koncertale, dhe me këtë nuk i është përmbajtur detyrës projektuese dhe normave teknike se si duhet të projektohet salla koncertale. - Projekti me shifrën 1001 në projektin e tij nuk i është përmbajtur detyrës projektuese ku kërkohen 10 zyre për stafin, ai nuk e ka plotësuar këtë pikë. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së në super ekspertizën e dt.19.06.2023 me Nr. 263/23, ku konstaton, citojmë : “Eksperti konstaton se projektuesi nuk ju ka përmbajtur detyrës projektuese në këtë pikë dhe e konsideron si të bazuar. Komisioni i vlerësimit duhet të merr parasysh gjatë vlerësimit tek kriteret për poentim, mbarim citati. Komisioni i Vlerësimit të Projekteve nuk e ka marrë për bazë fare këtë kriter dhe po ashtu nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së. - Projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk e ka prezantuar situacionin dhe përdhesen si duhet, pasi që nuk mund të lexohet projekti se ku ka gjelbërim, parkingje apo shtigje të ecjes, duke mos iu përmbajtur detyrës projektuese e cila kërkon që të trajtohet edhe pjesa e oborrit : - Projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk ka parapare vendosjen e një ekrani Led siç është kërkuar në detyrën projektuese : Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së, në super ekspertizën e dt.19.06.2023 me NR. 263/23, ku konstaton, citojmë : Pas shqyrtimit të fakteve të përmendura eksperti shqyrtues konstaton se në detyrën projektuese janë të përcaktuara kërkesat për lokacionin dhe rregullimin e hapësirave të jashtme, gjithashtu edhe kriteri kryesor gjatë vlerësimit të projekteve – Kriteri hapësinor. Pretendimi është i bazuar dhe duhet merret parasysh gjatë vlerësimit të projekteve në poentim, mbarim citati.”

Konkluzion : Si konkluzion mund të thuhet se Juria Profesionale e caktuar nga AK-Komuna e Lipjanit pas tri Vendimeve të OSHP-së: Vendimi i OSHP-së Nr. Nr. 2023/0263 dt. 22/06/2023, Vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0516 dt.26.09.2023 dhe Vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0909 dt. 31/01/2024, që lënda të kthehet në Rivlerësim, ka vepruar në mënyrë joprofesionale, diskriminuese dhe tendencioze në raport me kompaninë tonë. Përmes vlerësimit jo të drejtë të projekteve pjesëmarrëse në këtë konkurs projektimi, autoriteti kontraktues na ka diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së si dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit pa asnjë bazë ligjore. Po ashtu autoriteti kontraktues duke shpallur vlerësuar në mënyrë joreale projektet që nuk kanë respektuar kërkesat e Detyrës projektuese dhe rregullativën ligjore në fuqi, ka shkelur rëndë nenin 59 të LPP-së. Po ashtu ky komision i krijuar për Rivlerësimin e Projekteve Ideor nuk ka respektuar Vendimet e OSHP-së, ku ishte konstatuar shumë e qartë se asnjëri nga shifrat 7373,1119 dhe 1001 nuk i ka përmbushur Kriteret e dhëna në FDT dhe po ashtu nuk ka respektuar Specifikimet Teknike të Detyrueshme

dhe Detyrën Projektuese. Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt.05.03.2024, ku autoriteti kontraktues vetëm në mënyrë sipërfaqësore është munduar të arsyetojë vendimin e tyre për refuzim të kërkesës për rishqyrtim. Autoriteti kontraktues vetëm potencon se projekti ka marr pikët e caktuara sipas propozim projektit të dorëzuar mirëpo faktikisht nuk argumenton pse na janë dhënë aq pak pikë

Arsyetimi i AK-së vërtetohet qartë se është subjektiv, joprofesional dhe tendencioz. Pra arsyetimi i AK-së qartë tregon tendencën për diskriminim ndaj kompanisë tonë. Autoriteti kontraktues përsëri nuk zbaton vendimet e OSHP-së dhe me këtë veprim bënë shkelje ligjore, sepse vendimet e OSHP-së janë të ekzekutueshme dhe detyruese për autoritetet kontraktues. Nga këto dëshmi kuptohet qartë se AK-së nuk ka respektuar tre Vendimet e OSHP-së - Vendimi i OSHP-së Nr. Nr. 2023/0263 dt. 22/06/2023, Vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0516 dt.26.09.2023 dhe Vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0909 dt. 31/01/2024..

Me këto vendime është konstatuar se projektet me shifrat 7373, 1001 dhe 1119 nuk i kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj bazuar në mosrespektimin e kërkesave të Detyrës Projektuese të këtij konkursi projektimi dhe rrjedhimisht edhe të rregullativës ligjore në fuqi, këto projekte janë projekte të papërgjegjshme. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së hyn në kuadër të shkeljeve të rënda e që parashihen në nenin 97.1 pika h të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik. Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i projekteve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nuk është bërë në harmoni me dispozitat e nenit 73-80 të LPP-së sepse juria nuk ka bërë vlerësim objektiv në këtë rast. Ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik, sepse nuk janë përmbushur asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita për tu anuluar aktiviteti i prokurimit. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar ne si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi kualifikuar tutje, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Gjatë gjithë këtij procesi të prokurimit, ne jemi diskriminuar, duke mos u trajtuar profesionalisht tenderi ynë, prandaj pas tre vendimeve të OSHP-së, e të cilët na kanë dhënë të drejtë, kërkojmë nga OSHP-ja që ta detyrojë autoritetin kontraktues të zbatojë vendimet e OSHP-së, në të kundërtën nuk kem arsye të ankohe mi në OSHP, nëse një autoritet nuk zbaton vendimet e OSHP-së disa herë radhazi dhe kalon pa pasoja dhe ndëshkime. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa ju në këtë rast keni vepruar në kundërshtim me këto dispozita dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Më këto veprime, AK-ja ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik lidhur me vlerësimin e pavarur dhe të drejtë e të barabartë. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “N.N.SH. " Vizion Project ” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Nenet: 1, 2, 6, 7, 10, 59, 60, 62, 73 dhe 80 të LPP-së si dhe neni 55 i Rregullores nr. 001/2022, të KRPP-së.Prandaj, konzerciumi jonë

“N.N.SH” Vizion Project & REBUS ARCHITECTS L.L.C. & ArchiUNIK SH.P.K, bazuar në atë që u tha si më lartë kërkojmë nga OSHP që të nxjerrë : Vendim -Të aprovet kërkesa jonë në tërësi si e bazuar të kthehet lënda në rivlerësim dhe ri vendosje tek AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN dhe të aplikohen drejt dispozitat ligjore dhe të anulohet vendimi për Anulim të aktivitetit të prokurimit.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: “Komisioni për vlerësim të projekteve ka vlerësuar në përpikmëri të gjitha projektet sipas propozimeve të dorzuara poashtu edhe projektin me kodin 1124 është vlerësuar në përpikmëri dhe pas vlersimit nga komisioni përkatës ka fituar pikët siç edhe jeni njoftuar në bazë të njoftimit mbi vendimin e AK me datë 28.02.2024. Projekt ideja me shifren 1124 tek hyrja për artistet e propozuar nga parking publik nuk është trajtuar në formën e duhur dhe për komisionin e vlersimit nuk mund të aprovet si e tillë, daljet emergjente nga selia ndikohen nga rampa që kyqet në bodrum kur dihet që daljet emergjente janë më se të rëndësishme në projekte të tilla sepse është objekt që shfrytzohe nga qytetare me një numër të madh të qytetarëve dhe kjo pikë nuk është trajtuar në mënyrën e duhur dhe nuk mund të kalohet në këtë mënyrë. Fasadat e jashtme të këtij projekti nuk janë në formën arkitektonike që mund ti përket një objekti të tillë dhe një fasadë e tillë nuk jep ndonjë epitete të qendres së kulturës dhe i njëjti projekt ka marr pikët e caktuara në bazë të propozim projektit që ka aplikuar. Kriteri projektin më ekonomik nuk është trajtuar dhe një propozim projekt i tillë nuk është i pranueshëm dhe është vlersuar nga komisioni me pikët e caktuara. Rregullimi i parterit nuk krijon ndonjë pamje që ndërlidhet me këtë objekt është bërë një trajtim sikur të ishte duke u ndërtuar ndonjë objekt banimi dhe jo qendër kulturore dhe nga komisioni ka marr pikët e caktuara në bazë të projekt propozimit të dorëzuar. Funksioni-organizimi i brendshëm në këtë ide projekt jep një mos ndërlidhje mes hapësirave dhe kthinave që janë planifikuar dhe duke e parë që ky është një projekt i një qendre kulturore është dashtë që të përdoret thjeshtësi që funksioni të jetë sa më i lehtë dhe i njëjti projekt ka marr pikët e caktuara sipas propozim projektit të dorëzuar. Pretendimi juaj është i Pa Bazuar sepse projekti juaj është vlersuar nga komisioni përkatës në bazë të projekt propozimit të dorëzuar shifra 1124 dhe i njëjti projekt ka marr pikët e caktuara që keni pranuar në platformen e prokurimit me datë 28.02.2024.

AK ka zbatuar me përpikmëri rregullat e nxjerra nga KRPP,

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 216/2024, ndërsa me datë 31.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/216 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “N.N.SH. " Vizion Project ” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/216 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Lidhur me pretendimet e OE ankues që kanë të bëjnë me projektet 7373, 1119 dhe 1001 eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet janë të njëjta me pretendimet të cilat janë të shtjelluara në super ekspertizën me nr. 263/23 të dorëzuar me datën 19.06.2023. Të njëjtat pretendime janë dhëne edhe në ankesën 2023/909 për të cilat janë nxjerrë përfundime dhe vendime.

Për më tepër eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit Neni 23.1 Vlerësimi i Koncept Projekteve : Pikët Totale për kritere: 100, ndërsa pragu minimal 50 pikë për të kaluar në fazën e II-të (hapja e zarfave të kandidatëve) e në bazë të të cilave OE sipas kodeve 1119, 1001 dhe 7373 nuk e kanë kaluar prapun (nuk kanë kaluar në fazën e dytë) dhe se nuk e kanë ankimuar vendimin e AK-së e për të cilën janë pajtuar prandaj pretendimet e OE ankues nuk janë të qëndrueshme.

Prandaj duke pas parasysh sqarimet për pretendimet e shtjelluara me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se këto pretendime duhet të trajtohen në bazë të nenit 105 paragrafi 2-16 të LPP-së si çështje të gjykuara “res judicata”.

Konstatimi i dytë (II) : “Lidhur me pretendimin e dytë të OE në lidhje me vlerësimin e projektit me kodin 1124 nga juria e emëruar nga AK-ja Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se AK-ja gjatë publikimit të vendimit të AK-së nuk kishte bashkëngjitur letrat standarde mbi vlerësimin e jurisë. Pas kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues AK-ja në përgjigjën e kërkesës për rishqyrtim ka dhënë procesverbalin me arsyetimin e poentimit nga juria. Vlen të theksohet se AK-ja ka dhënë kryesisht arsyet e njëjta me vendimin e datës 28.10.2023. Po ashtu edhe OE ankues në pretendimet e tij në ankesë nuk ka atakuar pikat e vlerësimit të jurisë por ka dhënë një vlerësim të përgjithshëm se vlerësimi i jurisë nuk ka qenë objektiv. Sa i përket pjesës ku OE i referohet shkeljes së nenit 59 dhe arsyetimin se juria nuk e ka bërë vlerësimin objektiv OE ankues nuk e ka dhënë asnjë argument që do të arsyetonte pikat e vlerësimit nga juria e emëruar nga AK-ja si dhe duke pas parasysh vendimet e mëparshme të OSHP-së dhe faktin se juria për vlerësimet dhe arsyetimet e njëjta në dy vendimet e fundit ka dhënë poentime të ndryshme eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Ndërsa sa i përket pjesës ku OE ankues i referohet shkeljes së nenit 7 trajtimi i OE në mënyrë të barabartë eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron nga vet fakti se në vendimin e AK-së të datës 27.10.2023 dhe vlerësimit të fundit të datës 28.02.2024 OE ankues ka marrë më së shumti pikë nga OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa lidhur me pjesën e pretendimit të OE ankues se është shkelur neni 1 dhe 6 duke eliminuar OE ankues si ofertues të përgjegjshëm me çmimin më të ultë eksperti shqyrtues sqaron se aktiviteti i prokurimit për këtë konkurs projektimi është i përcaktuar në dy faza dhe se faza e

dytë është citoj “Po ashtu operatorët ekonomik duhet të ofrojnë ofertën financiare në pliko të mbyllur dhe të veçantë nga zgjidhja ideore e cila hapet vetëm pas vlerësimit të zgjidhjes ideore”. Prandaj pretendimi se OE ankues e ka ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ultë nuk qëndron nga vet fakti se ofertat financiare nuk janë hapur. Prandaj në bazë të sqarimeve si më lartë ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësas e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse ankesa në këtë rast.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan.” me nr. të prokurimit: "613-23-536-2-2-3". Paneli shqyrtues vlerëson se ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.N.SH. " Vizion Project ” dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.N.SH. " Vizion Project ” janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan.” me nr. të prokurimit: "613-23-536-2-2-3", të mbetet në fuqi anulimi i aktivitetit prokurimit.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësas dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues, duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga OSHP ka pasur edhe tri vendime paraprake Nr.2023/0263, 2023/516 dhe 2023/0909, ku janë nxjerrë mbi bazën e ankesës nga i njëjti ankues i cili është edhe tani ankues, dhe lëndët janë kthyer në ri-vlerësim, andaj edhe një pjesë e pretendimeve ankimore duhet të trajtohen si çështje të gjykuara konform nenit 105.2.16 të LPP.

Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Paneli shqyrtues duke e pasur parasysh se ky aktivitet i prokurimit është prolonguar nga AK deri më tani, duke bërë shkelje të nenit 59 të LPP, si dhe shkelje tjera të dispozitave ligjore dhe këtë e vërtetojnë edhe raportet ekspertizave paraprake të cilat janë hartuar nga ekspertë profesional dhe ekspert teknik të cilët kanë konstatuar shkeljet e AK me rastin vlerësimit dhe ri-vlerësimit të disa hershëm nga ana e AK, kjo për Panelin Shqyrtues është papërgjegjshmëri komplete e zyrtarëve të autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues vlerëson se prej inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit të zhvilluar nga ana e AK Komuna Lipijan ka pasur shkelje të theksuara të dispozitave ligjore për Prokurim Publik nga ana e zyrtarëve të këtij institucioni, të cilat janë të evidentuara edhe me vendimet paraprake që ka nxjerrë OSHP për këtë aktivitet të prokurimit. Kjo definitivisht është manifestuar me jo profesionalizëm me çrast dëmtojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit.

Kështu që, si pasojë e gjendjes së krijuar dhe mos prolongimin deri në pafundësi të këtij aktiviteti të prokurimit, përgjegjësin për anulimin e këtij aktivitet të prokurimit e mban vetë autoriteti kontraktues edhe sa i përket përmbajtjes së të gjitha shkresave, ndërsa, PSH detyrimisht duhet ta lë në fuqi anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me nenin 1 të LPP, ngase në bazë të kësaj praktike AK do të vazhdoj me një arsye tjetër të eliminimit të këtij OE ankues, si dhe me të vërtet është i qëndrueshëm fakti të cilin e thekson AK në përgjigje të raportit të ekspertit shqyrtues se: *"Duhet te ju njoftojme qe procesi i vlersimit te projekteve tani e tutje e ka zbehe kredibilitetin e procedures pasi qe eshte zbuluar identiteti i OE ankues ku i njejt e ka shfaq identitetin e tij ne kerkesat per rishqyrtim poashtu edhe ne ankesat e ushtruara ne OSHP. Vlersimi eshte ne kundershitim me rregulloren e prokurimit publik neni 55.24 te konkurs projektimi ku thuhet qe identiteti i pjesmarresve nuk duhet te ju shfaqe jurise profesionale (Ne kete rast vete OE ankues ka zbuluar identitetin e tij) ne kerkesat per rishqyrtim dhe vendimet e OSHP-se"*.

Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuse e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish vendimet e saj bazuar në gjetjet e ekspertëve shqyrtues dhe ekspertëve teknik me çrast ka pasur edhe raport të superkepsertizës me vendimin e (parë) kaluar për këtë aktivitet të prokurimit. Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të refuzojë raportet e ekspertëve, duke ripërsëritur se AK e konsideron se ankuesi nuk i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë

përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde.

Po ashtu, për të garantuar që ky vendim të reflektojë drejtësinë dhe integritetin e procesit të prokurimit, paneli vendosi që të kthejë tarifën në rastin e parashtrimit të ankesës nga operatori ekonomik ankues duke u bazuar në shkeljet e njëpasnjëshme të AK dhe nga papërgjegjësia e zyrtarëve të Autoritetit Kontraktues. Paneli gjithashtu vendosi që AK duhet të kompensojë operatorin ekonomik ankues për shpenzimet procedurale, në përputhje me dispozitat e nenit 30 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në këtë mënyrë ky vendim u bazua në synimin për të mbrojtur integritetin dhe ligjshmërinë e procesit të prokurimit, njëherësh siguroi që interesat e të gjitha palëve në këtë procedurë të mbrohen dhe që procesi i prokurimit të vazhdojë në mënyrë të drejtë dhe transparente.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - N.N.SH. " Vizion Project "**
- Arkivës së OSHP-së: